

## **Informacioni për ju që duhët të regjistroni kompetencën tuaj**

ky informacion për ju që jeni banor në vendpranim të integritimit dhe që duhët të regjistroni informacionet në lidhje me kompetencën tuaj.

Përpilimi i kompetencave është një pjesë e përbajtjes së detyrueshme të programit me kohë të plotë, dhe një pjesë e marrëveshjes për qëndrimin në vendpranimin e integritimit. Ju duhët të regjistroni kompetencën tuaj në mënyrë që të merrni udhëzimet më të mira të mundshme në lidhje me arsimin dhe punën në Norvegji, dhe që të jetë e mundur të ju ofrojmë një program të përshtatshëm me kohë të plotë. Mungesa e regjistrimit sjell pasoja për ju dhe për përbushjen tuaj të marrëveshjes rreth vendpranimit të integritimit. Mungesa e regjistrimit mund gjithashtu të ndikoj në përpjekjet e IMDI për të gjetur një komunë të përshtatshme banimi për ju.

### Pse është e rëndësishme që ju të regjistroni kompetencën tuaj?

Norvegjia ka disa zyra publike që punojnë për të udhëzuar personat në lidhje me arsimin, trajnimin dhe punën. Ata kanë nevojë për informacione në lidhje me kompetencat tuaja për të ju udhëzuar në mënyrë më të mirë të mundshme.

Nëse merrni leje qëndrimi dhe vendoseni me banim me asistencë publike, informacionet në lidhje me kompetencat tuaja janë një nga faktorët e shumta që IMDI i merr parasysh kur zgjedh një komunë banimi të përshtatshëm për ju.

Informacionët në lidhje me kompetencën tuaj do të shfrytëzohen më vonë për të ju dhënë udhëzime për karrieren, qëllimin përfundimtar, përbajtjen në programin e plotë kohor dhe programin hyrës.

### Baza për trajtim

Ju keni nënshkruar një marrëveshje për të marrë pjesë në një program me kohë të plotë si banor në vendpranimin për integritim. Për të përbushur qëllimin e kësaj marrëveshjeje, është e nevojshme që të regjistroni informacionët në lidhje me kompetencën tuaj. Përbushja e kësaj marrëveshjeje përbën bazën ligjore për përpunimin e informacioneve rreth jush. Kjo rjedh nga artikulli 6, nr. 1 shkronja b e Urdhëreses së Privatësisë që lejon përpunimin e të dhënave personale kur është e domosdoshme të përbushet një marrëveshje me personin që është i regjistruar.

### Informacion në lidhje me përmasën e regjistrimit

Gjatë regjistrimit të kompetencës tuaj, nuk mblidhen më shumë informacione rreth jush sesa janë grumbulluar për personat që janë pajisur me leje qëndrimi dhe pra kanë të *drejtë dhe janë të detyruar* të regjistrojnë kompetencat e tyre.

Personi që eventualisht ju udhëzon, gjatë regjistrimit mund të futë detaje në rubriken për tekstet e tija të lira për të plotësuar informacionin që ju e regjistroni në Kompass. Në rubriken tekstet e lira udhërrëfyeni fut vetëm informacionët shtesë të ato pika që i gjeni në Kompass.

Çfarë informacione rreth jush regjistrohen në Kompass:

- Shtetësia, gjinia dhe mosha
- Gjuhët që i dini
- Shkollimi/arsimimi
- Eksperienca e punës
- Cilat aktivitete keni praktikuar të i bëni që janë relevante për arsimimin dhe punën
- Interesat tuaja
- Dëshirat tuaja për arsimim dhe punë

### Kush do të ketë qasje në informacionët që i regjistroni

**Drejtoria për Integritim dhe Diverzitet (IMDI)** ka përgjegjësi për informacionët rreth kompetencës tuaj. IMDI ka depozituar emrin tuaj dhe numrin e referencës DUF, në mënyrë që të mund të identifikojmë informacionet tuaja.

**Qendrat e karrierës** të lidhura me bashkinë e qarkut do të ofrojnë udhëzime për karrieren bazuar në informacionët në lidhje me kompetencën tuaj. Nëse merrni leje qëndrimi dhe jeni në grupin e synuar

për programin hyrës, ju gjithashtu keni të drejtë dhe jen i të detyruruar të të kryeni udhëzimin për karrieren. Një udhërrëfyes karriere do të përdorë informacionët rreth jush për të ju dhënë më të mira të mundshme në lidhje me arsimimin dhe punën në Norvegji. Udhërrëfyesi i karrieres do të ndajë rezultatin e udhëzimit me komunën, IMDI dhe NAV.

**Enti Norvegjezë për Punë dhe e Mirëqenies (NAV)** mund të përdorë informacionët rreth jush për të ju dhënë udhëzime mbi mundësinë e gjetjes së një pune në Norvegji.

**Komuna në të cilën ndodhët vendpranimi** do të përdorë informacionët rreth jush për të përshtatur programin me kohë të plotë ose për masa promovuese të integritimit.

Nëse merrni leje qëndrimi dhe vendoseni me banim me asistencë publike, **komuna ku ju vendoseni**, do të përdorë informacionët për të ju dhënë juve një program hyrës të përshtatshëm, trajnim në studime norvegjeze dhe shoqërore ose për oferta tjera relevante të trajnimit.

Informacionët mund të përdoren për **qëllime specifike kërkimore dhe statistikore**.

#### Cilat të drejta i keni në rregullat e ruajtjes së privatësisë?

Ju keni të drejtë të shihni informacionet që janë regjistruar rreth jush. Ju keni të drejtë të kërkonti që informacionët e pasakta të përmirësohen ose të fshihen. Ju keni të drejtë të kërkonti që informacionët rreth jush të mos përdoren, mes tjerash nëse janë të pasakta. Ju keni të drejtë të ankoheni për përpunimin e informacioneve. Nëse dëshironi të ushtroni të drejten në lidhje me përpunimin e informacioneve tuaja, ju lutemi kontaktoni IMDI në adresën e mëposhtme elektronike: [post@imdi.no](mailto:post@imdi.no), ose drejtëpërdrejt protektorin e ruajtjes së privatësisë të IMDI në adresën e postës elektronike [personvernombud@imdi.no](mailto:personvernombud@imdi.no). Informacionët që i jepni do të depozitohen deri në 15 vjet. Për më shumë informacione në lidhje me të drejtat tuaja ju rekomandojmë faqet e internetit të Inspektoratit të të Dhënave <https://www.datatilsynet.no/rettigheter-og-plikter/den-registrertes-rettigheter/>, dhe deklaratën e IMDI për ruajtjen e privatësisë <https://www.imdi.no/om-imdi/personvern/>.

#### Regjistrimi:

**Dëshiroj të regjistroj kompetencën time.**

E kam kuptuar se për çfarë mund ose duhet të përdoren informacionët që i jap.

**Nuk dëshiroj të regjistroj kompetencën time.**

E kuptoj që regjistrimi i kompetencës është i nevojshëm për të më ofruar një program me kohë të plotë në vendpranimin e integritimit. E kuptoj se mungesa e regjistrimit do të rezultoj në një ofertë më pak të përshtatshme në lidhje me trajnimin, shkollimin dhe udhëzimin për punë dhe aktivitete në Norvegji. E kuptoj se mungesa e regjistrimit të kompetencës mund të ketë pasoja se në cilë komunë do të vendosem.